

MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS

BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT



Programi mësimor

Filozofia për fëmijë

për klasën IV, V ose VI*

- Programi mësimor i lëndës zgjedhore **Filozofia për fëmijë** (për klasat IV, V ose VI) është përgatitur brenda projektit **Erasmus+ SOPHIE - Philosophy with Children for Wider Social Inclusion**, i udhëhequr nga Shoqata e Filozofisë e Maqedonisë. Për realizim të suksesshëm të programit, rekomandohet fuqimisht ndjekja e “Manualit për mësimdhënësit për realizimin e orëve të lëndës **Filozofia për fëmijë për klasat IV, V ose VI**”, të përgatitur nga autorët: Martin Popovski, Maja Vaçun, Tomaž Grušovnik, Despina Verzagia, Nina Ravnik Palka, Gašper Pirc, Luka Trebežnik, brenda të njëjtit projekt.

Financuar nga Bashkimi Evropian. Qëndrimet dhe mendimet e shprehura janë vetëm të autorit(ëve) dhe nuk



Ко-финансирано од
Европска Унија



НАЦИОНАЛНА АГЕНЦИЈА
ЗА ЕВРОПСКИ ОБРАЗОВНИ
ПРОГРАМИ И МОБИЛНОСТ

pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e Bashkimit Evropian." të pasqyrojnë qëndrimet e Bashkimit Evropian apo të Agjencisë Ekzekutive Evropiane për Arsim dhe Kulturë (EACEA). As Bashkimi Evropian dhe as EACEA nuk mund të mbajnë përgjegjësi për to.

Lëndë zgjedhore: **FILOZOFIA PËR FËMIJË** (klasa 4, 5 ose 6)

TË DHËNAT BAZË PËR PROGRAMIN MËSIMOR

Lëndë mësimore	Filozofi për fëmijë
Lloj/kategori i lëndës mësimore	Lëndë zgjedhore / lëndë për të mbështetur zhvillimin personal dhe social të nxënësve
Klasa	IV (e katërta), V (e pesta) ose VI (e gjashta)
Tema/fushat në programin mësimor	• Hyrje në filozofi • Etikë • Çfarë dhe si ekziston? • Si dimë se diçka e dimë? • Bukuria dhe arti • Shoqëri e drejtë • Unë dhe të tjerët • Bioetikë • Temë e lirë
Numri i orëve	2 orë në javë / 36 orë në vit
Normativi i stafit mësimor	Profesor i diplomuar i filozofisë, VII/1 ose VIA (sipas MRK) dhe 240 ECTS

LIDHJET ME STANDARET KOMBËTARE

Programi mësimor përfshin kompetenca relevante nga fushat: **Letrariteti gjuhësor, Matematikë dhe Shkencat Natyrore, Zhvillimi Personal dhe Social, Shoqëri dhe Kulturë Demokratike, Shprehje Artistike dhe Kulturë**, sipas Standardeve Kombëtare për Arsimin Fillor.

	Nxënësi/nxënësja di dhe/ose mund të:
I-A.1	të shprehë dhe të transmetojë mendimet, ndjenjat, informacionet dhe qëndrimet e tij/saj në situata të ndryshme komunikimi në gjuhën amtare përmes mediave të ndryshme dhe për qëllime të ndryshme,

I-A.3	da të zhvillojë një dialog kritik dhe konstruktiv, duke shprehur qëndrimet e tij/saj me argumente,
-------	--

I-A.4	të përdorë gjuhën standarde, duke respektuar rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore në shprehjen gojore dhe të shkruar,
I-A.6	të identifikojë karakteristikat themelore të gjuhës amtare (alfabeti, historia, dialektet etj.) dhe ngjashmëritë dhe dallimet me gjuhë të tjera,
I-A.8	të kuptojë përmbajtjen e mesazheve audio: të jetë në gjendje t'i nxjerrë, analizojë, vlerësojë dhe përmbledhë informacionet nga mesazhet dhe t'i shprehë (me shkrim dhe gojarisht) me fjalët e tij/saj,
I-A.9	të kuptojë përmbajtjen e teksteve të shkruara: të jetë në gjendje t'i nxjerrë, analizojë, vlerësojë dhe përmbledhë informacionet nga teksti dhe t'i shprehë (me shkrim dhe gojarisht) me fjalët e tij/saj,
I-A.10	të kuptojë përmbajtjet e paraqitura vizualisht (diagrame, tabela dhe grafikë, ilustrime, animacione etj.): të jetë në gjendje t'i nxjerrë, analizojë, vlerësojë dhe përmbledhë përmbajtjet vizuale dhe t'i shpjegojë (me shkrim dhe gojarisht),
I-A.12	të përdorë informacione nga burime dhe media të ndryshme dhe t'i qaset atyre në mënyrë kritike, duke marrë parasysh burimin, kontekstin, qëllimin dhe besueshmërinë e informacionit të prezantuar,
III-A.5	të rekomandojë / të zbatojë masë në kontekste të ndryshme të jetës së përditshme,
III-A.6	të nxjerrë përfundime kur dy madhësi janë proporcionalisht të drejta dhe të përdorë proporcionalitetin për të zgjidhur probleme, për shembull, konvertimin nga një valutë në tjetrën,
III-A.23	të interpretojë tabela, grafikë dhe diagrame, të krahasojë rezultatet dhe të nxjerrë përfundime mbi saktësinë e hipotezës së vendosur,
III-A.25	të vendosë se si të verifikojë rezultatet dhe të mendojë nëse përgjigjja është e arsyeshme në kontekstin e problemit,
III-A.26	të vlerësojë efikasitetin e qasjeve të ndryshme për zgjidhjen e problemit dhe të përmirësojë mënyrën e zgjidhjes,
III-A.29	të shqyrtojë dhe të zgjedhë ide, të vëzhgojë, të parashikojë dhe të vendosë supozime (hipoteza), të mbledhë dhe vlerësojë prova, të verifikojë parashikimet, të planifikojë, organizojë dhe të kryejë kërkime, të regjistrojë, përpunojë, analizojë dhe të paraqesë rezultatet, si dhe të vlerësojë dhe diskutojë përfundimet,
III-A.30	të organizojë dhe të paraqesë të dhëna sasiore në formë tabelare, grafike, me diagrame dhe skica, dhe të interpretojë të dhëna nga fusha të ndryshme të paraqitura në mënyra të ndryshme,
III-A.33	të studiojë dhe të diskutojë për ndikimin e shkencës, teknologjisë dhe aktiviteteve njerëzore mbi mjedisin,
III-A.43	të identifikojë dhe të studiojë fenomene në natyrën e gjallë dhe të pajetë,
III-A.44	të kuptojë bazat e evolucionit dhe faktet themelore për origjinën, njëshmërinë dhe diversitetin biologjik të jetës në Tokë,

III-A.47	të zbatojë njohuritë për proceset themelore jetësore që ndodhin në nivelin e organizmave për të përmirësuar cilësinë e jetës së tij/saj,
III-A.51	të shpjegojë ndërveprimin midis njeriut dhe mjedisit dhe të identifikojë ndikimet pozitive dhe negative të njeriut mbi mjedisin,
III-A.53	të analizojë marrëdhëniet midis sistemeve ekologjike, sociale dhe ekonomike nga niveli lokal deri te ai global,
V-A.1	të dallojë mes një stili jetese të shëndetshëm dhe një stili jetese me rrezik në të gjitha fushat e jetës (përfshirë zakonet ushqimore, aktivitetet sportive dhe rekreative, si dhe sjelljen seksuale),
V-A.2	të zgjedhë dhe të ushtrojë aktivitete që sigurojnë zhvillimin dhe përmirësimin e shëndetit dhe mirëqenies së tij/saj mendore dhe fizike,
V-A.3	të identifikojë komponentët e ndryshëm të identitetit të tij/saj, i cili ndërtohet mbi bazën e përkatësisë në grupe të ndryshme sociale (p.sh., identitet gjinor, etnik dhe kombëtar) dhe mbi bazën e roleve të ndryshme që ka në jetë (p.sh., nxënës, djalë/bijë),
V-A.4	të bëjë vlerësim të aftësive dhe arritjeve të tij/saj (përfshirë pikat e forta dhe të dobëta) dhe mbi këtë bazë të përcaktojë prioritetet që do t'i mundësojnë zhvillim dhe përparim,
V-A.5	të njohë emocionet tek vetja dhe tek të tjerët, të kuptojë pasojat e reagimeve të tij/saj emocionale në situata të ndryshme dhe të përdorë strategji të përshtatshme për menaxhimin e emocioneve,
V-A.6	të vendosë qëllime për mësim dhe zhvillim personal dhe të punojë për të kapërcyer sfidat që lindin gjatë arritjes së tyre,
V-A.7	të përdorë përvojat e tij/saj për të lehtësuar mësimin dhe për të përshtatur sjelljen e tij/saj në të ardhmen,
V-A.9	të parashikojë pasojat e veprimeve të tij/saj dhe të veprimeve të të tjerëve mbi vetveten dhe mbi të tjerët,
V-A.10	të zbatojë parime etike kur vlerëson të drejtën dhe të gabuarën në veprimet e tij/saj dhe të të tjerëve dhe të shfaqë cilësi të larta karakteri (si ndershmëri, drejtësi, respekt, durim, kujdes, mirësjellje, mirënjohje, vendosmëri, guxim dhe autodisiplinë),
V-A.11	të veprojë në mënyrë të pavarur, duke qenë plotësisht i/e vetëdijshëm se nga kush, kur dhe si mund të kërkojë ndihmë,
V-A.12	të përballlet me sukses me presionet sociale,
V-A.14	të dëgjojë në mënyrë aktive dhe të reagojë në mënyrë të përshtatshme, duke treguar empati dhe mirëkuptim për të tjerët, dhe të shprehë shqetësimet dhe nevojat e tij/saj në një mënyrë konstruktive,

V-A.15	të bashkëpunojë me të tjerët për arritjen e qëllimeve të përbashkëta, duke ndarë pikëpamjet dhe nevojat e tij/saj dhe duke marrë parasysh pikëpamjet dhe nevojat e të tjerëve,
V-A.16	të njohë problemet në marrëdhëniet me të tjerët dhe të qaset në mënyrë konstruktive për zgjidhjen e konflikteve, duke respektuar të drejtat, nevojat dhe interesat e të gjitha palëve të përfshira,
V-A.17	të kërkojë informacion dhe mbështetje për veten, por edhe të japë informacion dhe mbështetje konstruktive në dobi të të tjerëve,
V-A.18	të studiojë duke bërë pyetje të përshtatshme, me qëllim të zbulimit të problemeve, të analizojë dhe vlerësojë informacionet dhe sugjerimet, dhe të verifikojë supozimet,
V-A.19	të japë sugjerime, të shqyrtojë mundësi të ndryshme dhe të parashikojë pasojat për të nxjerrë përfundime dhe për të marrë vendime të arsyeshme,
V-A.20	të analizojë në mënyrë kritike informacionet dhe provat sipas kriterëve përkatëse,
V-A.21	të analizojë, vlerësojë dhe përmirësojë mënyrën e tij/saj të të mësuarit,
VI-A.1	të shpjegojë se si faktorët shoqërorë ndikojnë mbi personalitetin dhe mjedisin dhe t'i marrë parasysh ato kur formon opinion dhe merr vendime,
VI-A.2	të analizojë sjelljen e tij/saj për të përmirësuar vetveten, duke vendosur qëllime reale dhe të arritshme për të vepruar në mënyrë aktive në komunitet,
VI-A.3	të formulojë dhe argumentojë pikëpamjet e tij/saj, të dëgjojë dhe analizojë pikëpamjet e të tjerëve dhe të sillet me respekt ndaj tyre, edhe kur nuk pajtohet,
VI-A.4	të bëjë reflektim kritik mbi vlerat dhe sjelljet personale dhe shoqërore në kontekste të ndryshme (sidomos në situata me ndjeshmëri etike), të respektojë normat dhe vlerat e pranura shoqërisht, por edhe t'i sfidojë kur mendon se është e nevojshme,
VI-A.5	të kuptojë dallimet midis njerëzve sipas çdo baze (përkatësia gjinore dhe etnike, mosha, aftësitë, statusi social, orientimi seksual, etj.),
VI-A.8	të kuptojë çfarë i bashkon dhe çfarë i ndan njerëzit në komunitet, dhe të gjejë mënyra për të kontribuar në përparimin e komunitetit, duke marrë parasysh nevojat dhe interesat e të gjithëve,
VI-A.12	të analizojë dhe të diskutojë në mënyrë kritike për vlerat e shoqërisë civile, rolet dhe sjelljet e ndryshme të qytetarëve dhe për rolin e tij/saj brenda saj,
VI-A.13	të analizojë konceptin e të drejtave të njeriut dhe të drejtave të fëmijëve, të identifikojë rastet e shkeljes së të drejtave dhe të ndërmarrë aktivitete për respektimin e tyre pa dallim,

VI-A.15	të identifikojë situata ku qytetarët mund të ndikojnë në jetën e komunitetit dhe të angazhohet për përmirësimin e kushteve,
VI-A.18	të analizojë në mënyrë kritike kërcënimet e zhvillimit të paekuilibruar mbi mjedisin dhe të kontribuojë aktivisht në mbrojtjen dhe përmirësimin e tij,
VI-A.25	të shpjegojë karakteristikat e mjediseve natyrore dhe shoqërore dhe lidhjen e tyre me organizimin e jetës së njerëzve.
VIII-A.1	të shfaqë njohuri për format e ndryshme të shprehjes artistike nga të gjitha fushat e kulturës (letërsia, muzika, artet vizuale, artet interpretative, artet dekorative, arkitektura, dizajni).
VIII-A.2	të identifikojë manifestimet e ndryshme të kulturës popullore dhe ndikimin e tyre në zhvillimin e vlerave estetike.
VIII-A.3	të shprehë idetë, përvojat dhe emocionet e veta duke përdorur forma artistike ose të tjera të shprehjes krijuese (individuale ose kolektive).
VIII-A.4	të interpretojë idetë, përvojat dhe emocionet e shprehura në produktet artistike të krijuara nga të tjerët që i përkasin kulturës së vet ose kulturave të tjera.
VIII-A.6	të identifikojë dallimet dhe ngjashmëritë midis kulturës së vet dhe kulturave të tjera në mjedisin e ngushtë dhe të gjerë, dhe të analizojë lidhjen dhe ndërpendencën e tyre.
VIII-A.7	të njohë dhe të shpjegojë se si shenjat kulturore ndryshojnë me kalimin e kohës dhe në kontekste të ndryshme.
VIII-A.8	të njohë rëndësinë dhe të shpjegojë përfitimet dhe sfidat e globalizimit dhe lidhjen e çështjeve lokale me lëvizjet globale.
VIII-A.9	të njohë dhe të shpjegojë se si kultura të cilës i përket (përfshirë traditën dhe fenë) ka ndikuar në formimin e identitetit të tij/saj dhe në mënyrën e të shikuarit të botës.
VIII-A.10	të identifikojë dhe të rishqyrtojë stereotipet dhe paragjykimet ndaj anëtarëve të grupeve të tjera kulturore që shfaqen në mjedisin e tij/saj.
VIII-A.11	të njohë praninë e etnocentrizmit dhe të identifikojë elementët në kulturë që kontribuojnë në shfaqjen e tij.
VIII-A.12	të interpretojë botën jo vetëm nga këndi i anëtarëve të kulturës së vet, por edhe nga perspektiva e kulturave të tjera.
	Nxënësi/nxënësja kupton dhe pranon se:

I-B.2	me përdorimin e gjuhës në kontekste dhe mjedise të ndryshme, dhe në forma të ndryshme, mundësohet komunikim dhe ndërveprim efektiv.
-------	---

	(gjatë gjithmonë duke pasur parasysh me kë realizohet komunikimi),
I-B.3	Përmes leximit të teksteve me përmbajtje dhe strukturë të ndryshme zhvillohet shkrim-leximi, formohet një pamje më e gjerë për veten dhe botën, dhe nxiset shkrimi si nga nevoja ashtu edhe nga kënaqësia.
I-B.4	Përmbajtja dhe mënyra e shprehjes së mendimit të vet mund të kontribuojë në mirëmbajtjen dhe përmirësimin e komunikimit, por edhe të shkaktojë keqkuptime dhe konflikte.
I-B.5	Leximi dhe shprehja në gjuhën amtare janë të rëndësishme për zhvillimin dhe nxitjen e krijimtarisë dhe të menduarit kritik.
III-B.2	Njohuritë nga matematika gjejnë përdorim në shumë fusha të jetës së përditshme.
III-B.4	Mësimi i matematikës mund të jetë argëtues dhe interesant.
III-B.5	Kurioziteti, sistematikësia dhe inovacioni janë thelbësore për zhvillimin e mendimit shkencor-hulumtues.
III-B.6	Burimet natyrore të Tokës janë të kufizuara dhe përdorimi i pakujdesshëm i tyre ka pasoja mbi cilësinë e jetës.
III-B.8	Çdo individ është përgjegjës për ruajtjen e mjedisit natyror në rrethin e afërt dhe më gjerë, dhe duhet të zhvillojë ndërgjegje ekologjike dhe të veprojë drejt mbrojtjes dhe qëndrueshmërisë së mjedisit jetësor.
III-B.9	Duhet të kuptojë përparësitë, kufizimet dhe rreziqet e teorive shkencore dhe aplikimin e tyre, dhe të tregojë një qëndrim të zhvilluar ndaj marrjes së vendimeve të duhura dhe ndërtimit të vlerave, duke përfshirë edhe aspektin moral në zgjidhjen e problemeve.
V-B.2	Ndërtimi i identitetit të vet kontribuon në forcimin e vetëbesimit dhe në zhvillimin e personalitetit.
V-B.4	Çdo veprim që ndërmerr ka pasoja për të dhe/ose për mjedisin e tij/saj.
V-B.5	Nga mënyra se si i qaset zgjidhjes së problemeve dhe përballjes me konfliktet varet nëse problemet do të zgjidhen, respektivisht nëse konfliktet do të mbyllen.
V-B.7	Iniciativa, këmbëngulja, qëndrueshmëria dhe përgjegjshmëria janë të rëndësishme për realizimin e detyrave, arritjen e qëllimeve dhe tejkalimin e sfidave në situata të përditshme.
V-B.8	Ndërveprimi me të tjerët është dypalësh – ashtu si ka të drejtë nga të tjerët të kërkojë që t’i mundësohet përmbushja e interesave dhe nevojave të tij/saj, po ashtu ka përgjegjësi t’u japë hapësirë të tjerëve për të përmbushur interesat dhe nevojat e tyre.
V-B.9	Kërkimi i feedback-ut dhe pranimi i kritikës konstruktive çon në përparim personal si në nivel individual, ashtu edhe në atë social.
V-B.10	Mësimi është një proces i vazhdueshëm që nuk përfundon në shkollë dhe nuk kufizohet vetëm në arsimin formal.

VI-B.1	Nuk duhet të bëjë diskriminim bazuar në dallimet midis njerëzve (përkatësi gjinore dhe etnike, moshë, aftësi, status shoqëror, orientim seksual, etj.).
VI-B.2	Të gjithë njerëzit, përfshirë edhe fëmijët, kanë të drejtë të shprehin mendimet dhe qëndrimet e tyre dhe të marrin pjesë në marrjen e vendimeve që lidhen me nevojat dhe interesat e tyre.
VI-B.3	Të drejtat e njeriut janë universale, dhe kufijtë e të drejtave të secilit janë të drejtat dhe liritë e të tjerëve.
VI-B.4	Respekti i paanshëm i të drejtave dhe lirive të njeriut është çelësi për mirëqenien e individëve dhe të shoqërisë në tërësi.
VI-B.5	Barazia, drejtësia dhe kohezioni social janë të domosdoshme për funksionimin e suksesshëm të komunitetit.
VI-B.6	Angazhimi personal dhe bashkëpunimi me të tjerët janë të rëndësishme për realizimin e interesit të përbashkët publik.
VI-B.7	Çdo qytetar ka detyrën të sillet në mënyrë përgjegjëse ndaj bashkëqytetarëve, komunitetit dhe shoqërisë në tërësi, duke pasur gjithmonë parasysh pasojat e veprimeve të tij ndaj të tjerëve dhe mjedisit.
VI-B.9	Çdo qytetar duhet të marrë përgjegjësi për ndryshimet në natyrë të shkaktuara nga aktivitetet e njeriut.
VI-B.10	Njohja e historisë dhe gjeografisë mundëson një kuptim më të mirë të botës në të cilën jetojmë.
VI-B.11	Çdo person ka të drejtë të zgjedhë fenë që e konsideron të vetën, ose të zgjedhë të mos i përkasë asnjë feje, pa pasur pasoja nga kjo zgjedhje.
VI-B.12	Shteti ynë është një shoqëri multikulturore/multi-etnike ku jetojnë anëtarë të kulturave/etnive të ndryshme, dhe çdo qytetar i saj është përgjegjës të kontribuojë në shkëmbimin ndërkulturor dhe respektimin e të drejtave të njeriut në interes të jetesës së përbashkët në një shoqëri të integruar dhe etnikisht kohezive.
VIII-B.1	Arti dhe format e tjera të shprehjes kulturore kontribuojnë në kuptimin dhe ndryshimin e botës.
VIII-B.2	Qëndrimi kritik ndaj produkteve të ndryshme artistike është i rëndësishëm për zhvillimin e vlerave estetike individuale dhe shoqërore.
VIII-B.3	Respektimi dhe promovimi i kulturës së vet kontribuon në forcimin e identitetit dhe dinjitetit kulturor.
VIII-B.4	Diverziteti kulturor ndikon në zhvillimin e identitetit të anëtarëve të kulturave të ndryshme.
VIII-B.5	Dallimet midis kulturave duhet të shihen si mundësi për mësim dhe si sfida për mirëkuptim dhe përparim të ndërsjellë.

VIII-B.6	Respektimi dhe promovimi i kulturave të tjera kontribuon në sigurimin e respektit për kulturën e vet nga ana e të tjerëve.
----------	--

REZULTATET E MËSIMIT

Tema 1: Hyrje në filozofi	
Njohuri/aftësi	
- Njihet me pyetjet themelore filozofike. - Njihet me konceptet e të menduarit logjik, shpjegimit dhe dhënies së argumenteve.	
Qëndrime/vlera	
- Pranon rëndësinë e të menduarit të bazuar në ndjenjën e kureshtjes. - Kupton rëndësinë e zhvillimit të mendimit dhe dhënies së argumenteve. - Pranon rëndësinë e bisedës së kujdesshme dhe të durueshme. - Pranon rëndësinë e bashkëpunimit dhe ndershmërisë në detyrat dhe përgjegjësitë e punës.	
Përmbajtjet (dhe nocione) dhe numri i orëve	Shembuj të aktiviteteve
Pyetjet dhe mendimet e çuditshme (pyetje filozofike, të menduarit, shpjegimi, dhënia e argumenteve) Numri i orëve: 2	• Loja e quajtur „Topi magjik me mikrofon“ përdoret për njohjen e ndërsjellë të nxënësve dhe njohjen e mësuesit me nxënësit, si dhe për njohjen e nxënësve me rregullat e orëve të filozofisë. Nxënësit ulen në rreth dhe prezantohen një nga një, duke përmendur edhe një aktivitet të preferuar. Vetëm nxënësi që mban topin ka “mikrofonin e ndezur” dhe mund të dëgjohet, ndërsa të tjerët dëgjojnë me vëmendje dhe nuk mund të dëgjojnë sepse nuk kanë “mikrofon”. Para fillimit të lojës, nxënësit njihen me “katër rregullat e orëve të Filozofisë”: 1. Mos ki frikë të thuash atë që mendon, sepse nuk ekziston përgjigje e gabuar; 2. Mendo shumë, por edhe më shumë dëgjo atë që thonë të tjerët; 3. Thuaj lirshëm nëse je dakord apo jo me mendimin e dikujt tjetër, por jep arsye pse; 4. Është në rregull të ndryshosh mendim. Njerëzit që nuk ndryshojnë kurrë mendim janë ata që nuk mendojnë kurrë.

	• Lexohet tregimi „Sofi dhe pyetjet e çuditshme“ nga koleksioni „Aventurat mendore të Sofisë“ (ofruar si material mësimor me programin), ose ndonjë nga tregimet e tjera („Sofi dhe kutia me mendime“, „Sofi dhe mençuria“, „Viti i Ri – unë e re“, „Tregimet për gjyshin“ dhe „Rastësisht apo patjetër“). Lexohet ngadalë dhe me kujdes, duke bërë pushime kur hasen pyetje të rëndësishme filozofike në tregim. • Fillon një bisedë lidhur me pyetjet që dalin nga tregimi. Disa nga pyetjet mund të jenë: A ka ndodhur që ndonjë i rritur të mos dinte të përgjigjej në ndonjë pyetje tëndën? Cila pyetje ishte ajo?; A e konsideron pyetjen e Sofisë „A e dinë macet që janë mace?“ si pyetje „çuditshme“? Pse? • Përmes pyetjeve dhe përgjigjeve arrihet qartësimi i dallimit midis pyetjeve filozofike dhe llojeve të tjera të pyetjeve. (Shpjegim i detajuar i hapave për realizimin e këtyre aktiviteteve, si dhe aktivitete të tjera të propozuara, mund të gjendet në Manualin për mësues në skenarin e orës nr. 1.1.) • Lexohet tregimi „Sofi në kurth“ nga koleksioni „Aventurat mendore të Sofisë“ ose ndonjë nga tregimet „Sofi dhe rregullat“, „Sofi dhe fjalët e vogla“ dhe „Sofi dhe dita e pazakontë“. Fillon biseda lidhur me pyetjet që dalin nga tregimi: Çfarë mendon, pse Sofi nuk mund të gjejë një përgjigje të thjeshtë, me „po“ ose „jo“, për pyetjet e Goranit?; A vëren diçka të përbashkët në dy pyetjet që Goran i bën Sofisë?; Si do të veproje në vend të Sofisë në situatën me pyetjet e pazakonta?; Çfarë mendon, pse Goran nuk mund t’i përgjigjet Sofisë nëse fjalja e fundit e shkruar në tabelë është e vërtetë apo e rreme?; A dallohen pyetjet e Goranit nga pyetja e fundit e Sofisë? etj. • Diskutohet për ekzistencën e rregullave në bisedë, për rëndësinë e këtyre rregullave dhe nevojën për një qasje të drejtë dhe mirëkuptuese në bisedë. (Shpjegim i detajuar i hapave për realizimin e këtyre aktiviteteve, si dhe aktivitete të tjera të propozuara, mund të gjendet në Manualin për mësues në skenarin e orës nr. 1.2.)
• Mendim dhe argumentim (të menduarit, shpjegimi, dhënia e argumenteve, qasje e ndershme dhe e mirëkuptueshme ndaj bisedës) Numri i orëve: 2	• Lexohet tregimi „Sofi dhe pyetjet e çuditshme“ nga koleksioni „Aventurat mendore të Sofisë“ (ofruar si material mësimor me programin), ose ndonjë nga tregimet e tjera („Sofi dhe kutia me mendime“, „Sofi dhe mençuria“, „Viti i Ri – unë e re“, „Tregimet për gjyshin“ dhe „Rastësisht apo patjetër“). Lexohet ngadalë dhe me kujdes, duke bërë pushime kur hasen pyetje të rëndësishme filozofike në tregim. • Fillon një bisedë lidhur me pyetjet që dalin nga tregimi. Disa nga pyetjet mund të jenë: A ka ndodhur që ndonjë i rritur të mos dinte të përgjigjej në ndonjë pyetje tëndën? Cila pyetje ishte ajo?; A e konsideron pyetjen e Sofisë „A e dinë macet që janë mace?“ si pyetje „çuditshme“? Pse? • Përmes pyetjeve dhe përgjigjeve arrihet qartësimi i dallimit midis pyetjeve filozofike dhe llojeve të tjera të pyetjeve. (Shpjegim i detajuar i hapave për realizimin e këtyre aktiviteteve, si dhe aktivitete të tjera të propozuara, mund të gjendet në Manualin për mësues në skenarin e orës nr. 1.1.) • Lexohet tregimi „Sofi në kurth“ nga koleksioni „Aventurat mendore të Sofisë“ ose ndonjë nga tregimet „Sofi dhe rregullat“, „Sofi dhe fjalët e vogla“ dhe „Sofi dhe dita e pazakontë“. Fillon biseda lidhur me

	pyetjet që dalin nga tregimi: Çfarë mendon, pse Sofi nuk mund të gjejë një përgjigje të thjeshtë, me „po“ ose „jo“, për pyetjet e Goranit?; A vëren diçka të përbashkët në dy pyetjet që Goran i bën Sofisë?; Si do të veproje në vend të Sofisë në situatën me pyetjet e pazakonta?; Çfarë mendon, pse Goran nuk mund t'i përgjigjet Sofisë nëse fjalia e fundit e shkruar në tabelë është e vërtetë apo e rreme?; A dallohen pyetjet e Goranit nga pyetja e fundit e Sofisë? etj. • Diskutohet për ekzistencën e rregullave në bisedë, për rëndësinë e këtyre rregullave dhe nevojën për një qasje të drejtë dhe mirëkuptuese në bisedë. (Shpjegim i detajuar i hapave për realizimin e këtyre aktiviteteve, si dhe aktivitete të tjera të propozuara, mund të gjendet në Manualin për mësimdhënës në skenarin e orës nr. 1.2.)
Tema 2: Etika	
Njohuri/Aftësi	
• Njofton dhe dallon çfarë është e drejtë dhe çfarë është e padrejtë. • E njeh dhe kupton të vërtetën si vlerë përmes shembujve konkretë. • Njofton çfarë është sjellje e mirë dhe çfarë është sjellje e keqe.	
Qasjet/Vlerat	

- E kupton rëndësinë e rregullave për sjellje të mirë.
- Pranon rëndësinë e mirësisë dhe veprimeve të mira si thelbësore për bashkëjetesën e mirë me të tjerët.
- Respekton mendimet e ndryshme.
- Kupton se një bisedë e sinqertë, e kujdesshme dhe e durueshme është e rëndësishme për mirëkuptimin me të tjerët dhe për të mirën e të gjithëve.

Përmbajtje (dhe nocione) dhe numri i orëve	Shembuj aktivitete
• A duhet gjithmonë të themi të vërtetën? (drejtësi, e vërtetë, e saktë, e gabuar) Numri i orëve: 2	• Nxënësit ulen në rreth dhe fillon loja “Telefoni i prishur”. Nëse fjala e dëgjuar që duhet ta shqiptojë me zë nxënësi/nxënësja i/e fundit ndryshon nga ajo që e ka thënë nxënësi/nxënësja i/e parë, fillon biseda për njërin nga pyetjet e mëposhtme: A gënjen ai/ajo kur thotë diçka ndryshe nga fjala që është thënë e para? Kur themi që diçka është gënjeshtër? A keni thënë ndonjëherë gënjeshtër? Si jeni ndjerë kur keni gënjyer? A keni dëgjuar për shprehjen “gënjeshtër e bardhë/e pafajshme” apo shprehjen “gënjeshtër me bisht”? Çfarë kuptimi kanë ato? etj. Nëse fjala e nxënësit/nxënësës së parë është e njëjtë me fjalën e nxënësit/nxënësës së fundit, atëherë pyetja e parë shtrohet në këtë mënyrë: “Nëse nxënësi/nxënësja i/e fundit do të thoshte diçka ndryshe nga ajo që e ka menduar nxënësi/nxënësja i/e parë, a do të thoshte kjo që ai/ajo ka gënjyer?” • Lexohet tregimi “Kush është fajtor?” (i bashkëngjitur si shtojcë e skenarit për orën nr. 2.1. nga Udhëzuesi për mësues) pas së cilës fillon biseda për atë që është interesante ose e pazakontë në tregim. Pas përfundimit të bisedës së shkurtër, vendosen katër fletë letre në pjesë të ndryshme të klasës, në të cilat janë shkruar qëndrime të lidhura me tregimin. Nxënësit duhet të qëndrojnë pranë fletës ku është shkruar qëndrimi me të cilin pajtohen më shumë. Për shembull: “Jan duhej të gënjente për ta mbrojtur shokun e tij Tine”, “Jan duhej të thoshte se fqinji Petar e theu dritaren”; “Jan duhej t’i thoshte Tinët që t’ia tregonte të vërtetën babait të tij” dhe “Tjetër” (nxënësit e zgjedhin këtë opsion nëse mendojnë që zgjidhja duhet të jetë ndryshe nga ato të ofruara). Pasi nxënësit të zgjedhin qëndrimin me të cilin pajtohen më shumë, fillon biseda ku për këto qëndrime duhet të jepen argumente. • Bëhet bisedë për pasojat që kanë thënia e së vërtetës dhe gënjeshtër në situata të ndryshme, si dhe përgjithësisht për çështjen nëse gjithmonë duhet ta themi të vërtetën. (Shpjegim i detajuar i hapave për realizimin e këtyre aktiviteteve, si dhe aktivitete të tjera të propozuara, mund t’i gjeni në Udhëzuesin për mësues në skenarin për orën nr. 2.1.)

- | | |
|--|---|
| <ul style="list-style-type: none"> • Si të veprojmë? (njohja e koncepteve etike, e mira dhe e keqja, veprimet e drejta në situata të vështira, biseda e kujdesshme, bashkëpunimi) | <ul style="list-style-type: none"> • Ushtrim në të cilin nxënësit me zgjedhje të rastësishme nxjerrin fletë letre me të shkruara hiponime/hiperonime përkatëse me qëllim që të formohen grupe. Pas përfundimit të ushtrimit fillon biseda për pyetjet e mëposhtme: Si i keni dalluar cilat fjalë i përkasin së bashku? A ekziston ndonjë mënyrë tjetër me të cilën mund të lidhen fjalët? Qëllimi i këtij ushtrimi është të... |
|--|---|

Numri i orëve: 2	Të dallohen dhe të grupohen llojet e ndryshme të koncepteve dhe eventualisht të njihen konceptet etike, me çka ushtrohet mendimi kritik. - Nxënësit ndahen në grupe prej katër vetash dhe secila grup merr një problem të ndryshëm etik. Për shembull: Tre shokë shesin ëmbëlsira shtëpie në tregun lokal. Me paratë e fituara së bashku vendosin të blejnë bileta për llotari. Dy prej tyre nuk kanë fat dhe nuk fitojnë asnjë shpërblim, por i treti fiton një biçikletë. Fillon biseda në grupe për pyetjet e mëposhtme: Në sa mënyra të ndryshme mund të vazhdohet tregimi? Cilat janë dallimet mes këtyre vazhdimeve të ndryshme? Nëse do të duhej të ishte një nga personazhet në tregim, cili personazh do të ishte? Çfarë do të bëje po të ishte një nga personazhet në tregim? Pas përfundimit të ushtrimit, mendimet ndahen me nxënësit e tjerë. - Bëhet bisedë për pyetjen nëse gjithmonë është e lehtë të vendosësh si të veprosh drejt. (Shpjegim i detajuar i hapave për realizimin e këtyre aktiviteteve, si dhe aktivitete të tjera të propozuara, mund t'i gjeni në Udhëzuesin për mësues në skenarin për orën nr. 2.2.)
Tema 3: Çfarë dhe si ekziston?	
Njohuri/aftësi	
- Dallon realen nga e imagjinuara. - Dallon vetitë thelbësore dhe jothelbësore të objekteve. - Dallon konceptet matematikore nga objektet fizike.	
Qëndrime/vlera	
- Kupton që gjërat ekzistojnë në mënyra të ndryshme. - I kupton dallimet dhe lidhjet mes gjërave në botë. - Pranon që biseda është e rëndësishme për të kuptuar mendimet e ndryshme për botën dhe gjithçka brenda saj.	
Përmbajtje (dhe nocione) dhe numri i orëve	Shembuj për aktivitete
Mënyrat e ekzistimit dhe vetitë e objekteve (reale dhe të imagjinuara, vetitë thelbësore dhe jothelbësore, konceptet matematikore dhe objektet fizike) Numri i orëve: 2	- Nga nxënësit kërkohet që në një fletë letre të shkruajnë: - diçka që është në klasë në atë moment, - diçka që ka qenë në klasë, por nuk është më, - diçka që kurrë nuk do të mund të ishte në klasë dhe - diçka që do të dëshironin të ishte në klasë.

	Pas përfundimit të ushtrimit, nxënësit i ndajnë përgjigjet e tyre për pyetjen e parë dhe diskutohet nëse të gjithë pajtohen që ato objekte janë në klasë dhe se ekzistojnë. Për pyetjen e dytë diskutohet nëse të gjithë mund të kujtohen për ato objekte dhe nëse ato objekte vazhdojnë të ekzistojnë. Për pyetjen e tretë dhe të katërt, nxënësit i vendosin përgjigjet e tyre...
--	--

	• Përgjigjet në grupe për realen ose të imagjinuarën. • Nxënësit pyeten nëse ndonjëherë kanë parë një kafshë të caktuar. Më pas imagjinojnë një grup të madh të atyre kafshëve, pas së cilës diskutohet se si mund të imagjinojmë kaq shumë kafshë bashkë, nëse kurrë më parë nuk i kemi parë së bashku. • Nxënësve u tregohen fotografi të një peme gjatë katër stinëve, pas së cilave mund të parashtrihen këto pyetje: A është kjo e njëjta pemë? Çfarë është ajo që nuk ndryshon gjatë stinëve? Çfarë është në të vërtetë një pemë? (cilat janë tiparet që e bëjnë atë të jetë pemë?) Nxënësit ndahen në dy grupe. Njëra grup sillet sikur janë jashtëtokësorë që kurrë më parë nuk kanë parë një pemë dhe sfidojnë grupin tjetër të përpiqet t’ua shpjegojë çfarë është në të vërtetë një pemë. • Diskutohet nëse gjërat e imagjinuara ekzistojnë, nëse numrat ndodhen brenda objekteve apo jashtë tyre dhe cilat janë vetitë më të rëndësishme për një objekt të caktuar. • Gjatë zhvillimit të kësaj ore mund të përdoren edhe pjesë nga materiali didaktik “Sofi në vendin e mendimit: Aventurë për mendjet e reja” (i ofruar si material mësimor së bashku me programin). (Shpjegim i detajuar i hapave për realizimin e këtyre aktiviteteve, si dhe aktivitete të tjera të propozuara, mund t’i gjeni në Udhëzuesin për mësues në skenarin për orën nr. 3.1.)
• Pojmet abstrakte dhe koncepti i materies (pojmë konkrete dhe abstrakte, gjëra jo-materiale, gjëra të imagjinuara dhe fantazi) Numri i orëve: 2	• Nxënësit ndahen në dy grupe dhe me zgjedhje të rastësishme nxjerrin kartela në të cilat janë shkruar fjalët: drejtësi, e vërtetë, solidaritet, ndershmëri, falje, sinqeritet, miqësi, guxim, mençuri etj. Secili grup nxjerr tre kartela dhe më pas u jepet kohë që të diskutojnë mes tyre për kuptimin e fjalëve. Pas kësaj, grupet zgjedhin përfaqësues të cilët duhet t’ua shpjegojnë fjalët grupit tjetër pa i shqiptuar vetë fjalët. Shpjegimi mund të bëhet gojarisht – duke dhënë shembuj ose përmes një tregimi të shkurtër; vizualisht – përmes vizatimit; ose fizikisht – përmes pantomimës. Çdo nxënës nga grupi mund të zgjedhë nga një fjalë ose një mënyrë shpjegimi. Pas prezantimeve, grupi tjetër ka disa minuta për të provuar t’i gjejë fjalët që janë shpjeguar dhe më pas i shkruajnë ato në një fletë letre. Ushtrimi zhvillohet në mënyrë të alternuar për secilën nga gjashtë fjalët në të dy grupet. Pas përfundimit të ushtrimit, nxënësit duhet të shpjegojnë pse kanë zgjedhur atë mënyrë për të sqaruar fjalën. • Pas kësaj pason një bisedë për atë nëse shpjegimet i drejtojnë mirë drejt fjalëve që duhet të gjenden dhe nëse (dhe pse) është më e vështirë të shpjegohen/përshkruhen fjalë që lidhen me gjëra jo-materiale sesa fjalë që lidhen me objekte materiale.

- | | |
|--|---|
| | <ul style="list-style-type: none">• Gjatë zhvillimit të kësaj ore mund të përdoren edhe pjesë nga materiali didaktik “Sofi në vendin e mendimit: Aventurë për mendjet e reja” (i ofruar si material mësimor së bashku me programin). |
|--|---|

	...material mësimor së bashku me programin). (Shpjegim i detajuar i hapave për realizimin e këtyre aktiviteteve, si dhe aktivitete të tjera të propozuara, mund t'i gjeni në Udhëzuesin për mësues në skenarin për orën nr. 3.2.)
Tema 4: Si e dimë që diçka e dimë?	
Njohuri/aftësi	
• E di dhe kupton çfarë është e vërtetë dhe çfarë është gënjeshtër. • Dallon dijen nga mendimi dhe besimi. • Kupton që gjatë vëzhgimit përdoren shqisat e ndryshme, por edhe mendja.	
Qëndrime/vlera	
• E pranon rëndësinë e të menduarit me kujdes kur përballlet me besime të paeksploruara dhe paragjykime. • E kupton rëndësinë dhe vlerën e shkencave. • E pranon rëndësinë e bashkëpunimit si rrugë drejt dijes. • Kupton dhe pranon që ekzistojnë aftësi të ndryshme shqisore dhe fizike tek njerëzit. • I respekton mendimet dhe besimet e të tjerëve. • E kupton rëndësinë e dhënies së argumenteve. • E pranon rëndësinë e ndarjes së mendimeve dhe qëndrimeve me të tjerët.	
Përmbajtje (dhe nocione) dhe numri i orëve	Shembuj për aktivitete
• Dije, mendim, besim (dhënia e argumenteve, besimi shkencor dhe joshkencor, mendimi, dija) Numri i orëve: 2	• Lexohet një tekst (i përgatitur më parë nga mësuesi) në të cilin përmbahen disa folje, si: beson, mendon, konsideron, di, dëshmon, pas së cilës pason një bisedë për dallimin midis “mendon” dhe “di”, si dhe midis “beson” dhe “di”. Pas bisedës, nxënësit shkruajnë tre fjali: për diçka që e dinë me siguri; për diçka në të cilën besojnë, por nuk mund ta dëshmojnë; dhe për mendimin e tyre lidhur me një temë filozofike. Më pas, nxënësit zgjedhin një fjali për ta ndarë me të tjerët. Përcaktohet cili lloj fjalish është më i pranishëm ndër ato të ndara dhe zhvillohet bisedë për lidhjen midis atij lloji fjalish me dy llojet e tjera. • Lexohet një tekst nga materiali didaktik “Sofi në vendin e mendimit: Aventurë për mendjet e reja” (i ofruar si material mësimor me programin), në të cilin përfshihet një problem moral në rastin e përhapjes së njëkohshme të zjarrit në dy shtëpi. Lloji i zgjidhjeve që do të propozojnë nxënësit për këtë problem krahasohet me llojin e zgjidhjeve që ata do të ofrojnë për një ekuacion matematikor të thjeshtë.

- | | |
|--|--|
| | <ul style="list-style-type: none">• Zhvillohet bisedë për atë nëse është më e lehtë të flitet për gjërat që i dimë, për gjërat në të cilat besojmë apo për mendimet tona mbi gjëra të caktuara. Gjithashtu, parashtrohen pyetje për... |
|--|--|

	...kuptimin e shkencës, për respektimin e mendimeve të ndryshme, për tolerancën ndaj besimeve të ndryshme etj. (Shpjegim i detajuar i hapave për realizimin e këtyre aktiviteteve, si dhe aktivitete të tjera të propozuara, mund t'i gjeni në Udhëzuesin për mësues në skenarin për orën nr. 4.1.)
• Iluzione shqisore (shqisat, të menduarit) Numri i orëve: 2	• Në tabelë shkruhen këto fjalë: shoh, dëgjoj, nuhas, prek, shijoj. Nxënësit, me zgjedhje të rastësishme, marrin objekte të ndryshme: pambuk, mostër parfumi, copë tekstili, lodër, fotografi, kuti muzikore etj. Me secilin objekt, nxënësit marrin edhe një karamelë me shije të ndryshme. Më pas, secili nxënës përshkruan objektin që ka zgjedhur dhe karamelën që ka marrë. Mësuesi në tabelë shënon sa herë është përmendur secila nga foljet: shoh, dëgjoj, nuhas, prek dhe shijoj. Hapet biseda për atë se cili shqisë e konsiderojnë më të nevojshme. Biseda mund të fillojë me një nga pyetjet: Pa cilën shqisë jeta do të ishte shumë më e vështirë? Cilin shqisë e përdorni më shumë në jetën e përditshme? A keni dashur ndonjëherë ta "fikni" një shqisë? • Nxënësve u shfaqen disa iluzione të njohura optike dhe ata duhet të përshkruajnë çfarë po ndodh me shikimin e tyre. Imazhet mund të përmbajnë iluzione ku prapaskena zhduket, fotot janë të turbullta, zhduken ose ngjyrat ndryshojnë kur fokusohet shikimi apo ndryshohet sfondi etj. Hapet bisedë për përvojat e ndryshme. Diskutimi mund të fillojë me pyetje si: A mund të mbështetemi gjithmonë tek shqisa e shikimit? A e shohim të gjithë të njëjtën gjë? A mund të jemi të sigurt për atë që shohim? • Nxënësve u shfaqet një foto e një objekti të zmadhuar dhe një foto e të njëjtit objekt në madhësinë natyrale. Fillon diskutimi për këto pyetje: A ka ndryshuar madhësia e objektit apo ka ndodhur diçka tjetër? Si mund ta përcaktojmë madhësinë e objektit? Biseda mund të vazhdojë më tej: A mund të mbështetemi vetëm tek shqisat për ta kuptuar realitetin? A mund t'u besojmë gjithmonë shqisave? • Nxënësit marrin detyrë ta lexojnë versionin e përgatitur posaçërisht të “Mitit të shpellës” në materialin didaktik “Sofi në vendin e mendimit: Aventurë për mendjet e reja” (i ofruar si material mësimor së bashku me programin). Pas leximit, ata përgatisin një pikturë, punim artistik ose kolazh për ta paraqitur mitin, i cili më pas mund të përdoret si bazë për bisedë mbi pyetjen se sa mund t'u besojmë shqisave.

	(Shpjegim i detajuar i hapave për realizimin e këtyre aktiviteteve, si dhe aktivitete të tjera të propozuara, mund t'i gjeni në Udhëzuesin për mësues në skenarin për orën nr. 4.2.)
--	---

	...aktivitete, mund t'i gjeni në Udhëzuesin për mësues në skenarin për orën nr. 4.2.)
Tema 5: Bukuria dhe arti	
Njohuri/aftësi	
• E njeh dhe e kupton konceptin e bukurisë. • Dallon vetitë e ndryshme të bukurisë. • Dallon shfaqjet e ndryshme të bukurisë në natyrë dhe në shoqëri. • E kupton lidhjen midis bukurisë dhe mirësisë. • Njeh artin dhe format e ndryshme të artit.	
Qëndrime/vlera	
• E pranon rëndësinë e bukurisë në mjedisin dhe kulturën tonë. • E pranon rëndësinë e bukurisë dhe artit për veten dhe për të tjerët. • E pranon nevojën për shprehje artistike. • E pranon shprehjen e ndryshme artistike në kultura të ndryshme.	
Përmbajtje (dhe nocione) dhe numri i orëve	Shembuj për aktivitete
• Çfarë është bukuria? (e bukur, e shëmtuar, objektivitet, subjektivitet, kulturë, mjedis, natyrë) Numri i orëve: 2	• Dy nxënës shfaqin një pjesë të shkurtër teatrale të përgatitur më parë (dialogët e shoqëruar me ilustrime janë të ofruara në përmbledhjen e veçantë të mini-skenarëve teatrale të titulluar "Mini-teatri filozofik", e bashkëngjitur si material mësimor së bashku me programin). Gjatë shfaqjes, mësuesi i paraqet ilustrimet përkatëse për skenat. Pas shfaqjes, fillon një bisedë për përshtypjet dhe për atë nëse diçka i ka shtyrë nxënësit të mendojnë. Nëse shfaqet pjesa "Bukuria", nxënësve u bëhet pyetja me cilin personazh pajtohen dhe ndahen në tre grupe: ata që pajtohen me personazhin e Janës, ata që pajtohen me personazhin e Mateut dhe ata që nuk pajtohen plotësisht as me Janën, as me Mateun. Fillon biseda për atë nëse pajtohen që gjërat mund të jenë "gjysmë të shëmtuara" apo vetëm të shëmtuara ose të bukura. Diskutimi vazhdon me temën e "bukurisë së brendshme" dhe si bukuria mund të jetë e fshehur. Nëse gjatë bisedës nxënësit e ndryshojnë mendimin e tyre, atyre u lejohet t'i bashkohen ndonjë grupi tjetër. • Biseda vazhdon për atë pse disa gjëra janë të bukura, disa të shëmtuara, e disa as të bukura as të shëmtuara; për cilat veti diçka është e bukur ose e shëmtuar; nëse disa veti kanë të njëjtin apo efekt të ndryshëm kur i zbulojmë te gjëra të ndryshme; nëse natyra është më e bukur se qytetet apo e kundërta; nëse çdo gjë në natyrë është e bukur; nëse bukuria gjendet në vetë gjërat apo...

	...varet nga ata që e shohin; çfarë do të thotë "të kesh shije të ndryshme"; nëse kur diçka është e bukur, është e bukur për të gjithë; nëse bukuria është e lidhur me mirësinë; çfarë është bukuria etj. (Shpjegimin e detajuar të hapave për realizimin e këtyre aktiviteteve, si dhe aktivitete të tjera të propozuara, mund ta gjeni në Udhëzuesin për mësues në skenarin për orën nr. 5.1.)
• Çfarë është arti? (arti, llojet e artit) Numri i orëve: 2	• Dy nxënës performojnë një shfaqje teatrale të shkurtër, të përgatitur paraprakisht (dialogët e shoqëruar me ilustrime janë ofruar në përmbledhjen e veçantë të skenarëve të mini-teatrit me titull "Mini-Teatri Filozofik", e bashkangjitur si material mësimor së bashku me programin). Gjatë shfaqjes, mësuesi i shfaq ilustrimet përkatëse për skenat. Pas shfaqjes fillon diskutimi për përshtypjet dhe nëse diçka i ka nxitur për të menduar. Nëse zgjidhet shfaqja "Pse Van Gog? Pse jo unë?", pas interpretimit u bëhet nxënësve pyetja se cila pikturë u ka pëlqyer më shumë, piktura e Anës apo "Nata me yje" e Van Gogut, dhe ndahen në grupe përkatësisht. Pastaj bëhet pyetja nëse pajtohen me pohimin e personazhit të Ilinës se, edhe pse Ana pikturon bukur, ajo nuk është artiste. Diskutimi vazhdon me pyetjen nëse pajtohen me Anën se Ilina mendon se Van Gogu është artist, ndërsa ajo jo, vetëm për shkak të shijes së saj personale. Më pas shtrohet pyetja nëse piktura e Anës, nëse do të ishte e ekspozuar në një galeri, do të konsiderohej art. Nëse gjatë diskutimit nxënësit ndryshojnë mendim, u lejohet të bashkohen me një nga grupet e tjera. • Diskutimi vazhdon mbi disa nga temat e mëposhtme: • A duhet të jetë diçka e bukur për t'u konsideruar art? • A mund të jenë gjërat e shëmtuara art? • A janë veprat e vjetra artistike më të vlefshme se ato të rejtat? • A janë ndjenjat të rëndësishme kur vendosim nëse diçka është art apo jo? • Cila është arti juaj i preferuar? • Çfarë e bën një vepër artistike të jetë e njohur? • Kush vendos se çfarë është art? • Çfarë është arti? etj. (Shpjegimin e detajuar të hapave për realizimin e këtyre aktiviteteve, si dhe aktivitete të tjera të propozuara, mund ta gjeni në Udhëzuesin për mësues në skenarin për orën nr. 5.2.)

Tema 6: Shoqëria e drejtë

Njohuri/aftësi

- E njeh dhe e kupton drejtësinë dhe zbatimin e saj praktik në jetën e përditshme.
- E njeh rëndësinë e vendimmarrjes demokratike.
- E njeh dhe e kupton padrejtësinë dhe pasojat e saj në komunitet.
- E kupton mundësinë e keqpërdorimit të pushtetit vendimmarrës dhe pasojat e tij negative.

Qëndrime/Vlera

- E pranon dhe e kupton ndikimin e dëmshëm të padrejtësisë në komunitet.
- E pranon rëndësinë e drejtësisë në mjedisin e afërt dhe më të gjerë.
- E pranon dhe e kupton rëndësinë e bisedës, i respekton dhe i merr parasysh mendimet e të tjerëve.

Përmbajtje (dhe nocione) dhe numri i orëve

• **Demokracia dhe shoqëria e drejtë**
(demokraci, e drejtë, e padrejtë)
Numri i orëve: 4

Shembuj për aktivitete

• Lexohet një tregim me mesazh moral për rëndësinë e drejtësisë, për shembull, "**Dy macet dhe majmuni**" nga Ezopi. Nxënësit shkruajnë disa fjalë që mendojnë se janë më të rëndësishmet për tregimin dhe më pas japin shpjegim se si ato fjalë lidhen me tregimin. Nxënësit ndahen në çifte dhe çdo çift shkruan një pyetje që përmban një nga fjalët kyçe të tregimit. Çdo çift lexon pyetjen dhe e vendos në rrethin që kanë formuar nxënësit. Të gjithë së bashku zgjedhin një nga ato pyetje për të cilën dëshirojnë të diskutojnë. Nxënësit që kanë formuluar pyetjen e zgjedhur ua shpjegojnë të tjerëve pse e kanë zgjedhur atë pyetje dhe ndajnë mendimet e tyre për përgjigjen e mundshme. Më pas, detyra e tyre është t'i nxisin të tjerët të mendojnë për pyetjen e zgjedhur.

Gjatë diskutimit, mësuesi mund të bëjë këto pyetje:

- A është e drejtë që dikush të shfrytëzojë pozitën e tij në shoqëri për të arritur qëllime personale?
- Në cilat raste vendimet e komunitetit janë më të drejta?
- Kur themi se një vendim është demokratik?
- A mund të sillni shembuj të vendimmarrjes demokratike në mjedisin tuaj?

• Nxënësit përmendin sa më shumë fjalë që mund të lidhen me fjalën **demokraci**, dhe ato shkruhen në tabelë. Më pas, së bashku, mendojnë për demokracinë si një nga mënyrat e organizimit të jetës së përbashkët.

• Nxënësit luajnë një proces zgjedhor për **kryetar bashkie/president** të komunitetit të tyre në klasë. Nxënësit ndahen në tre grupe dhe secili grup merr udhëzime të veçanta:

- Grupi i parë zgjedh kandidatët dhe ndihmësit e tyre. Së bashku hartojnë një program që mund të përmirësojë jetën e përditshme në komunitet/klasë.
- Grupi i dytë është përgjegjës për organizimin e zgjedhjeve, përgatit fletët e votimit dhe vendin e votimit.

- Grupi i tretë, më i madhi, janë votuesit.

Pas dëgjimit të programeve dhe propozimeve të kandidatëve, ata votojnë për **kryetarin/presidentin e komunitetit**. Më pas bëhet një vlerësim i gjithë procesit dhe përmbajtjes së tij. Nxënësit duhet të shpjegojnë përvojën e tyre dhe çfarë kanë zbuluar dhe mësuar për drejtësinë, demokracinë dhe organizimin e një procesi nga i cili varet e gjithë komuniteti.

(Shpjegimin e detajuar të hapave për realizimin e këtyre aktiviteteve, si dhe aktivitete të tjera të propozuara, mund ta gjeni në **Udhëzuesin për mësues** në skenarët për orët nr. 6.1.)

	6.2.)
Tema 7: Unë dhe të tjerët	
Njohuri / Aftësi	
• I njeh dallimet mes vetes dhe të tjerëve. • Kupton se njohja e vetes dhe e të tjerëve është e rëndësishme për zhvillimin personal. • Mund të identifikojë cilat tipare personale e bëjnë atë të jetë ai që është. • Njeh se cilat gjëra në shoqëri ndikojnë në zhvillimin e tij dhe kontribuojnë që ai të jetë ai që është.	
Qëndrime / Vlera	
• Pranon se të menduarit është i rëndësishëm për zhvillimin personal. • E kupton dhe pranon rëndësinë e aftësisë për të dëgjuar, kuptuar, respektuar dhe reflektuar mbi qëndrimet dhe besimet e të tjerëve.	
Përmbajtjet (dhe nocione) dhe numri i orëve	Shembuj për aktivitete
• Kush jam unë? (unë, të tjerët, zhvillimi personal, personaliteti) Numri i orëve: 4	• Nxënësit marrin pjesë në lojën shoqërore "Kush jam unë dhe kush je ti?" (e ofruar si material mësimor së bashku me programin), të ndarë në grupe të vogla prej 5 nxënësish. Çdo nxënës hedh zar dhe lëviz përkatësisht për aq vende sa tregon zari në tabelë. Kur arrin në një fushë me pikëpyetje, tërheq një kartë me pyetje. Pasi nxënësi përgjigjet në pyetje, nxënësit e tjerë ftohen të marrin pjesë në diskutim mbi pyetjen dhe përgjigjen. Në tabelë ka edhe fusha me figura që tregojnë aktivitete përkatëse. Pyetjet që mund të bien gjatë tërheqjes së kartave janë, për shembull: • A është e mundur të bëhesh dikush tjetër ose diçka tjetër? Kur / në çfarë rrethanash? • A ndikon pamja jonë e jashtme në atë se kush jemi? • A do të ishte përsëri ti po të kishe një emër tjetër? Nëse e ndryshon emrin, a bëhesh dikush tjetër? • A dëshiron ndonjëherë të dukesh si dikush tjetër? Si kush, për shembull? • A duhet të përpiqemi të jemi si të tjerët apo është mirë të jemi ashtu siç jemi? Kur nxënësi arrin në një fushë me pikëçuditëse, ai/ajo tërheq një kartë me një aktivitet që duhet ta realizojë. Shembuj për fushat me aktivitete:

1. **"Shiko veten në pasqyrë dhe shpjego çfarë sheh!"**
 - Pikënisje për diskutim: Gjatë rritjes fytyrat tona ndryshojnë, por ne mbetemi të njëjtit.
2. **"Imagjino një ndjenjë dhe përpiku ta shprehësh me fytyrën tënde!"**
 - Nxënësit e tjerë duhet të gjejnë se cilën ndjenjë po përpiqesh të shprehësh.
 - Pikënisje për diskutim: Ndryshimi i sjelljes dhe ndjenjave na ndryshon ne.
3. **Foto me një xhup – aktivitet: "Vish një xhup/bluzë që i përket një shoku të klasës dhe pastaj trego kush je."**
 - Pikënisje për debat: *"Rrobat e bëjnë njeriun!"*

	• Nxënësit ndahen në çifte. Mësuesi u jep çdo çifti nga tre kartela me këto fjali të papërfunduara: • Vetëm unë mund të kem... • Unë dhe të tjerët mund të kemi... • Vetëm të tjerët mund të kenë... Më pas, nxënësit marrin fletëza ku janë shkruar fjali të paplota si: • ... përgjegjësinë që të mos gënjej / gënjejme / gënjejnë shokët e mi; • ... përgjegjësinë që të mos flas / flasim / flasin gjatë kohës që shohim film; • ... të njëjtët miq që kam unë; • ... rrobat që unë vesh; • ... prindërit e mi; • ... të njëjtin shije për muzikë ose interes për të njëjtin sport; • ... të njëjtat kujtime, etj. Nxënësit kanë për detyrë t'i rendisin fjalitë e paplota sipas tre kategorive të kartelave. • Pas kësaj aktiviteti, zhvillohet një diskutim ku nxënësit shpjegojnë arsyet për zgjedhjet e tyre. Qëllimi i ushtrimit është të dallohen veprimet dhe tiparet që janë thelbësore për personalitetin dhe identitetin tonë nga ato që janë rastësore dhe jo të rëndësishme. <i>(Shpjegime të detajuara për hapat e zhvillimit të këtyre aktiviteteve, si dhe aktivitete të tjera të propozuara, mund të gjeni në Udhëzuesin për mësues në skenarët për orët nr. 7.1 dhe 7.2.)</i>
Tema 8: Bioetika	
Njohuri / Aftësi	
• Vlerëson sa të mira apo të këqija janë disa veprime. • Kupton çfarë është solidariteti, drejtësia dhe dobia. • Kupton sa e ndërlikuar dhe e rëndësishme është roli i personelit mjekësor. • Kupton çfarë është e mirë dhe çfarë nuk është e mirë për mjedisin dhe kafshët. • Kupton se ka përgjegjësi për veprimet e veta para vetes dhe para të tjerëve.	
Qëndrime/vlera	

- E kupton dhe e vlerëson rëndësinë e jetës së të gjitha qenieve dhe vlerën e tërë natyrës së gjallë dhe jo të gjallë.
- E pranon dhe e respekton rëndësinë e ekologjisë.
- E kupton dhe e vlerëson rëndësinë e dhembshurisë në marrëdhëniet me gjithë botën e gjallë.
- E kupton dhe e pranon rëndësinë e mirëkuptimit të ndërsjellë dhe humanizmit.
- E pranon dhe e vlerëson rëndësinë e bashkëpunimit që është i rëndësishëm për të mirën e të gjithëve.

Përmbajtje (dhe nocione) dhe numri i orëve

Shembuj për aktivitete

• Mjedisi jetësor dhe të drejtat e kafshëve (mjedisi jetësor, të drejtat, përgjegjësia personale dhe përgjegjësia ndaj të tjerëve, dhembshuria) Numri i orëve: 2	• Zhvillohet ushtrimi i quajtur "Stacioni i autobusit". Në vende të ndryshme në klasë, në kartonë janë vendosur këto pyetje: A kanë kafshët të drejta?; Çfarë obligimesh kemi ndaj kafshëve?; A duhet ta mbrojmë mjedisin jetësor? Pse?; Çfarë mund të bëjmë çdo ditë për ta mbrojtur mjedisin jetësor?; A duhet të ekzistojnë ligje dhe dënime për sjelljen e keqe të njerëzve ndaj kafshëve dhe ndaj mjedisit jetësor?; A duhet të ricikloj? Pse?. Duke kaluar nga një stacion në tjetrin, nxënësit në fletëngjithëse i shkruajnë dhe i vendosin përgjigjet e tyre për pyetjet e vendosura në çdo stacion. Me leximin e përgjigjeve në çdo stacion, niset biseda. • Nxënësit marrin pjesë në lojën me role, ku ndahen në dy grupe: anëtarë të Ministrisë për mjedisin jetësor dhe kafshët dhe deputetë në Kuvend. Nxënësit që janë pjesë e Ministrisë tërheqin numra, pas së cilës mësuesi/ja thotë një numër me zgjedhje të rastësishme. Nxënësi që ka tërhequr atë numër është Ministri/Ministrja, ndërsa të tjerët janë këshilltarët e tij/saj. Secili nga anëtarët e Ministrisë propozon ligje që kanë të bëjnë me mjedisin dhe të drejtat e kafshëve. Propozimet duhet të përmbajnë këto formulime: Çdo qytetar duhet... Asnjë qytetar nuk guxon... Anëtarët e Kuvendit e ndjekin bisedën mes anëtarëve të Ministrisë dhe japin propozimet e tyre. Pastaj secili anëtar i Kuvendit i lexon me kujdes propozimet dhe nëse nuk pajtohet, thirret para të tjerëve të shpjegojë pse nuk pajtohet. Pas përfundimit të procedurës, secili anëtar i Kuvendit voton publikisht për propozimet, ndërsa mësuesi i shënon votat. Pason biseda për procedurën me të cilën janë miratuar ligjet dhe për problemet për të cilat është diskutuar. • Për këtë orë mund të përdoren edhe pjesë nga materiali didaktik "Sofi në vendin e mendimit: Aventurë për mendjet e reja" (i ofruar si material mësimor bashkë me programin). • Qëllimi i orës është të bisedohet për çështjet e lidhura me të drejtat e kafshëve dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor, si dhe për gjetjen e zgjidhjeve me të cilat do të respektohen të gjitha qenie të gjalla. • Në zbatimin e kësaj ore mund të përdoren edhe pjesë nga materiali didaktik "Sofi në vendin e mendimit: Aventurë për mendjet e reja" (i ofruar si material mësimor bashkë me programin). (Udhëzime të detajuara për hapat e zbatimit të këtyre aktiviteteve, si dhe aktivitete të tjera të propozuara, mund t'i gjeni në Udhëzuesin për mësues në skenarin për orën nr. 8.1.)
• Etika mjekësore dhe përgjegjësia (përgjegjësia personale dhe përgjegjësia ndaj të tjerëve, të drejtat, detyrimet, bashkëpunimi, dhembshuria)	• Lexohen dy tekste nga materiali didaktik "Sofi në vendin e mendimit: Aventurë për mendjet e reja" (i ofruar si material mësimor bashkë me programin). Njëri ka të bëjë me çështje morale në lidhje me solidaritetin, ndërsa tjetri me çështje morale në lidhje me vjedhjen. Nxënësit nxisen të bisedojnë për moralitetin e veprimeve të

Numri i orëve: 2	• Personazhet në tregim. Në fund, nxënësit ftohen të ndajnë ngjarje që ata i kanë dëgjuar ose përjetuar, e që përmbajnë probleme të ngjashme morale. Pastaj, ata, së bashku me nxënësit e tjerë, diskutojnë për pyetjet që dalin nga këto ngjarje. • Nxënësit ndahen në dy grupe me zgjedhje të rastësishme: mjekë dhe pacientë. Pastaj, nxënësit tërheqin kartela në të cilat është përshkruar roli i tyre në lojë: 1) rendi i ardhjes në spital; 2) urgjenca për ndihmë mjekësore; 3) mosha e pacientit; 4) roli i pacientit në shoqëri. Pacientët, një nga një, shpjegojnë pse pikërisht ata duhet të marrin të parët ndihmë mjekësore bazuar në informacionet e shkruara në kartelën e tyre. Mjekët mund të vizitojnë vetëm tre pacientë atë ditë. Pas një konsultimi të shkurtër, mjekët duhet të vendosin cilët tre pacientë do të vizitohen dhe më pas të arsyetojnë vendimet e tyre. Pacientët e përzgjedhur mund t'ia lëshojnë vendin e tyre një pacienti tjetër me arsyetim pse e morën atë vendim. Procesi përsëritet për ditët në vijim derisa të përcaktohet rendi i trajtimit të të gjithë pacientëve, i cili më pas shkruhet në tabelë. Pas përfundimit të aktivitetit, fillon biseda për vendimet e marra dhe orarin e fituar. • Përmes marrjes së roleve të mjekëve dhe pacientëve, një nga qëllimet e orës është të kuptohet kompleksiteti i punës së personelit mjekësor dhe përgjegjësia e tyre e madhe. (Udhëzime të detajuara për hapat e zbatimit të këtyre aktiviteteve, si dhe aktivitete të tjera të propozuara, mund t'i gjeni në Udhëzuesin për mësues në skenarin për orën nr. 8.2.)
Tema 9: Temë e lirë	
Njohuri/aftësi	
• E kupton nocionin e të menduarit të pavarur dhe zhvillimin e qëndrimeve dhe interesave të veta. • E kupton nevojën për të dhënë argumente.	
Qëndrime/vlera	
• E pranon rëndësinë e vetëdijes për veten dhe zhvillimin e vet si mendimtar dhe personalitet. • E pranon dhe e vlerëson kureshtjen dhe habinë në thellimin e njohurive. • E pranon dhe e respekton rëndësinë e dëgjimit, mirëkuptimit dhe respektimit të mendimit të tjetrit. • E pranon rëndësinë e bashkëpunimit në përballimin e sfidave.	
Përmbajtje (dhe nocione) dhe numri i orëve	Shembuj për aktivitete
• Temë e preferuar filozofike (mendim personal, kureshtje, habi, kreativitet, bashkëpunim, dhembshuri)	• Hapet diskutim me temë: A mund të zhvillohet diskutim filozofik për çdo temë? Nxënësit tregojnë aktivitetin e tyre të preferuar (sport, koleksionim, dëgjim muzike, shoqërim me miq, shikim videosh në internet, përdorim të rrjeteve sociale etj.). Nxënësit tregojnë një problem ose temë filozofike që lidhet me aktivitetin e tyre të preferuar.

Numri i orëve: 2	- Nxënësve u hapet diskutim nëse mund të zhvillohet diskutim filozofik për çdo temë. Nxënësit tregojnë aktivitetin e tyre të preferuar duke pasur parasysh temat që janë shqyrtuar në orët e mëparshme. Disa aktivitete mund të lidhen më lehtë me një temë filozofike, siç është dëgjimi i muzikës me temat e bukurisë dhe artit. Për disa të tjera do të nevojitet mendim dhe bisedë më e thellë. Për shembull, sporti mund të lidhet me problemin e drejtësisë, koleksionimi me problemin e pronësisë, shoqërimi me miqtë dhe përdorimi i rrjeteve sociale me problemin e miqësisë së vërtetë etj. Nxënësit duhet t'i arsyetojnë përgjigjet e tyre dhe të ndalen të lidhja midis aktivitetit të tyre të preferuar dhe temës filozofike. - Nxënësve u bëhet pyetja nëse ka ndonjë temë filozofike që i intereson posaçërisht, por nuk kanë arritur ta hapin në orët e mëparshme. Nëse shfaqet një temë/pyetje e tillë, hapet diskutim për të me të gjithë nxënësit. - Çdo nxënës tregon temën ose problemin e vet të preferuar filozofik që është diskutuar në orët e mëparshme. Çdo temë e përmendur shkruhet në tabelë dhe zhvillohet votimi. Çdo nxënës i vlerëson temat duke u dhënë 3, 2 dhe 1 pikë temave të preferuara. Tema/pyetja filozofike me më shumë pikë shqyrtohet sërish. Bëhet pyetja nëse diçka ka ndryshuar në mënyrën se si ata mendojnë për temën e tyre të preferuar dhe pastaj diskutohet pse kanë ndodhur ato ndryshime. (Udhëzime të detajuara për hapat e zbatimit të këtyre aktiviteteve, si dhe aktivitete të tjera të propozuara, mund t'i gjeni në Udhëzuesin për mësues në skenarin për orën nr. 9.1.)
• Çfarë është filozofia? (mendim filozofik, personalitet, mendim kritik, bashkëpunim, dhembshuri, zhvillim personal) Numri i orëve: 2	- Përgatitja e tortës filozofike. Nga nxënësit kërkohet të shkruajnë dy tema që ata mendojnë se janë më të rëndësishmet nga temat filozofike për të cilat është biseduar në orët e mëparshme. Ndërsa çdo nxënës shpjegon dy temat e tij të zgjedhura, ato shkruhen në tabelë. (Temat që përsëriten shkruhen vetëm një herë). Nxënësve u bëhet pyetja nëse disa nga temat e shkruara në tabelë mund të bashkohen në një temë. Para se të bashkohen disa nga temat në tabelë, nxënësit ftohen të arsyetojnë pse mendojnë se kjo mund të bëhet dhe hapet bisedë nëse lidhja e temave është e justifikuar. Gjithashtu nxitet biseda për mënyrën se si duhet të emërtohen temat e bashkuara. (Për shembull, temat filozofike nga fusha e etikës mund të grupohen së bashku. E njëjta gjë vlen edhe për fushat e tjera filozofike.) - Nxënësit ftohen përpara tabelës me qëllim që së bashku të përgatisin "recetën e tortës filozofike". Secili nxënës shkruan pikë pranë temave në tabelë sipas rëndësisë së tyre. (Shembull: nëse ka 10 tema, ata duhet t'i japin 10 pikë asaj teme që mendojnë se është më e rëndësishmja, 9 pikë për të dytën sipas rëndësisë e kështu me radhë.) Para se nxënësit t'i rendisin temat, përdoren kartona ku është shkruar një numër për të përfaqësuar temat në tabelë dhe ato vendosen në vende të ndryshme në klasë. Pasi nxënësit të kenë përfunduar me...

- Pasi të kenë përfunduar me renditjen e temave, nxënësit ftohen të ulen pranë kartonit që përfaqëson temën të cilës i kanë dhënë më shumë pikë, në mënyrë që në fund të ushtrimit të formohen grupe nxënësish. Fillon biseda me një pyetje për secilin grup lidhur me zgjedhjen e tyre për temën filozofike më të rëndësishme. Grupet e tjera arsyetojnë pse nuk pajtohen. Pas bisedës, nxënësve u jepet mundësia të ndryshojnë renditjen e tyre të pikëve dhe, nëse e ndryshojnë mendimin për temën më të rëndësishme, të ulen në një grup tjetër. Pikët e nxënësve për secilën temë përmbledhen dhe kështu përgatitet “receta për tortën filozofike”, pas së cilës nxirret përfundimi se nga çfarë është bërë “torta filozofike” më e shijshme. (Shembull: 96 gramë “mirësi dhe sjellje e mirë”, 83 gramë “bukuri dhe art”, 70 gramë “dije dhe besim” e kështu me radhë).
- Theksohet se përbërja e tortës paraqitet në mënyrë figurative përmes grupeve që janë formuar në klasë, të cilat kanë mendime të ndryshme, por se torta filozofike e shijshme mund të “piqet” vetëm kur të gjithë punojnë dhe argëtohen duke menduar së bashku.

(Udhëzime të detajuara për hapat e zbatimit të këtyre aktiviteteve, si dhe aktivitete të tjera të propozuara, mund t’i gjeni në Udhëzuesin për mësues në skenarin për orën nr. 9.2.)